



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT
AGJENCIA KOMBËTARE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

**NJOFTIM PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË KONKURRIMIT
“MËSUES PËR SHQIPËRINË” 2025.**

Regjistrimi i kandidatëve “Mësues për Shqipërinë” 2025 bëhet në **e-albania** në shërbimin
“**Aplikim për konkurrim për punësim si mësues**”.

Afati për aplikim është **nga data 02.06.2025 deri në datën 16.06.2025, ora 24:00 (15 ditë)**

**Për kandidatët që kanë dhënë provimin e licencës në maj 2025, ose janë në proces të
licensimi afati i aplikimit është nga data 13.06.2025-23.06.2025.**

- ✓ Kandidati aplikon në DRAP-in ku ka vendbanimin e përhershëm. Ai ka të drejtë të përzgjedhë deri në 3 (tre) ZVAP ku dëshiron të punësohet.
- ✓ Kandidati që zotëron më shumë se një licencë, ka të drejtë të konkurrojë në profilet sipas licencave përkatëse, duke bërë aplikim më vete për secilën licencë.
- ✓ Kandidati që dëshiron të punojë si mësues në dispozicion ose si mësues ndihmës, krahas aplikimit për profilin përkatës, në aplikimin e tij duhet të zgjedhë edhe opsionin “Mësues në dispozicion” ose “Arsim special”.
- ✓ Kandidati, i cili ka dhënë provimin e licencës për profilin që aplikon dhe ka rezultuar i suksesshëm, si dhe testimin për portalin “Mësues për Shqipërinë”, përzgjedh nëse do të ruajë pikët e testimit apo kërkon të ritestohet për këtë portal.
- ✓ Kandidati, i cili nuk ka detyrim licencimin sipas përcaktimeve ligjore dhe kandidati i arsimit parashkollor, do të zgjedhë opsionin “Dëshiroj të vazhdoj pa licencë”, për të vijuar më tej aplikimin.
- ✓ Sasia e pikëve të marra në provimin e licencës për profilin që aplikon konfirmohen automatikisht nga portali.

Dokumentacioni i aplikimit:

Të gjithë kandidatët për mësues, përfshirë dhe parashkollorin (*kandidatët që kanë qenë pjesëmarrës në portalet e mëparshme dhe kandidatët e rinj*), kanë detyrim të ngarkojnë online dosjen për konkurrim, në të kundërt, përjashtohen nga konkurrimi dhe hiqen nga lista e portalit.

1- Dokumentet që ngarkohen nga kandidati janë:

- a) **Kopje e diplomës/ave** për ushtrimin e profesionit të mësuesit dhe **listën e notave**, (të detyrueshme për t'u ngarkuar).
- b) Kopje e librezës së punës e plotësuar deri deri në momentin e aplikimit. **(nëse ka dhe dëshiron të vlerësohet me pikë).**
- c) Kopje e dëshmive të kualifikimit për kategoritë: “Mësues i kualifikuar”, “Mësues specialist”, “Mësues mjeshtër” **(nëse ka dhe dëshiron të vlerësohet me pikë).**
- d) Kopje e certifikatave me krediteve të trajnimeve të kryera brenda dhe jashtë vendit. Certifikatat me kredite të trajnimeve të kryera brenda vendit të jenë ofruar nga MAS, institucionet e varësisë ose nga agjencitë e akredituara. **(nëse ka dhe dëshiron të vlerësohet me pikë).**
- e) Kopje e dëshmisë së njohjes së gjuhës/ve të huaja **(nëse ka dhe dëshiron të vlerësohet).**

Sqarim!

- Kandidati, dosja e të cilit nuk përmban një nga dokumentin e detyrueshëm për t'u ngarkuar në aplikim, nuk kualifikohet.
- Për çdo kandidat që aplikon, sistemi përzgjedh në mënyrë automatike DRAP-in në të cilin do të shqyrtohet dosja, mbështetur në të dhënat e marra nga e-Albania, për vendbanimin e tij.
- Kandidati përzgjedh DRAP-in dhe tri prej ZVAP-ve përkatëse në të cilat dëshiron të aplikojë, si edhe profilin për të cilin është diplomuar dhe / ose licencuar.
- Gjatë aplikimit, kandidati konfirmon vërtetësinë e të dhënave si edhe vetëdeklaron gjendjen e tij gjyqësore.

Faza e parë: Vlerësimi i dosjeve të aplikimit:

1. KVD bën vlerësimin e dosjeve të aplikantëve për plotësimin e kriterëve ligjore, nga 08.06.2025 deri 27.06.2025 (15 ditë pune).
2. Kandidatët bëjnë ankimimin për vlerësimin me pikë dhe verifikimin e dosjeve për kualifikim, nga 01.07.2025 deri 03.07.2025.
3. KVD shqyrton ankesat dhe konfirmon kandidatët e kualifikuar, të cilët futen në testim apo mbartin pikët e portalit 2024, deri më 10.07.2025.

Faza e dytë: Testimi i informatizuar:

- I. QSHA harton kalendarin dhe zhvillon testimin e informatizuar brenda datës 25.08.2025. Kalendarin e testimit të informatizuar publikohet në faqet zyrtare të AKAP, DRAP dhe QSHA.
- II. Kandidati ankimon në QSHA dhe për dijeni AKAP, brenda 3 ditë pune nga marrja e rezultatit. QSHA, brenda 5 ditë pune e shqyrton, i kthen përgjigje ankuesit dhe reflekton ndryshimin e pikëve, kur pranohet ankesa.
- III. QSHA nxjerr rezultatet e testit të informatizuar brenda datës 31.08.2025.

Faza e tretë: Lista përfundimtare

Lista përfundimtare e kandidatëve së bashku me renditjen e tyre përfundon brenda datës 02.09.2025

Linku për të aksesuar shërbimin: *Aplikim për konkurrim për punësim në portalin*

“Mësues për Shqipërinë”:

https://ealbania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=16306

Aneksi nr.1

Ndarja territoriale

AGJENCIA KOMBËTARE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

Rruga “Aleksandër Moisiu”, Tiranë

I. DREJTORIA RAJONALE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR TIRANË
(Adresa: Rruga “Jeronim De Rada”, Tiranë)

<u>Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar</u>	<u>Bashkia</u>
Kamëz	Kamëz
Tiranë	Tiranë
Kavajë	Kavajë
Vorë	Vorë
Rrogozhinë	Rrogozhinë

II. DREJTORIA RAJONALE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR DURRËS
(Adresa: Lagjia Nr.13, Rruga “Egnatia” Kutia Postare 2001, Durrës)

<u>Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar</u>	<u>Bashkia</u>
Dibër	Dibër
Krujë	Krujë
Durrës	Durrës
Bulqizë	Bulqizë
Mat	Mat
Klos	Klos

Shijak	Shijak
--------	--------

III. DREJTORIA RAJONALE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR LEZHË
(Adresa: Sheshi “Gjergj Kastrioti”, kati 2, godina OKF “Gjergj Lacaj”, Lezhë)

<u>Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar</u>	<u>Bashkia</u>
Has	Has
Tropojë	Tropojë
Mirditë	Mirditë
Malësi e Madhe	Malësi e Madhe
Vau Dejës	VauDejës
Pukë – Fushë Arrëz	Pukë dhe Fushë Arrëz
Kukës	Kukës
Lezhë	Lezhë
Kurbin	Kurbin
Shkodër	Shkodër

IV. DREJTORIA RAJONALE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR KORÇË
(Adresa: Lagjja 18, Rruga “Dhimitër Denasi” 7001, Korçë)

<u>Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar</u>	<u>Bashkia</u>
Dimal	Dimal
Kuçovë	Kuçovë
Cërrik	Cërrik
Belsh	Belsh
Peqin	Peqin
Gramsh	Gramsh

Librazhd	Librazhd
Përrenjas	Përrenjas
Maliq	Maliq
Kolonjë	Kolonjë
Berat	Berat
Korçë - Pustec	Korçë dhe Pustec
Devoll	Devoll
Pogradec	Pogradec
Elbasan	Elbasan
Skrapar	Skrapar
Poliçan	Poliçan

V. DREJTORIA RAJONALE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR FIER
(Adresa: Lagjja “Kastriot”, Rruga “Leon Rei”, Fier)

<u>Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar</u>	<u>Bashkia</u>
Patos	Patos
Roskovec	Roskovec
Divjakë	Divjakë
Mallakastër	Mallakastër
Selenicë	Selenicë
Finiq-Dropull	Finiq dhe Dropull
Tepelenë - Memaliaj	Tepelenë dhe Memaliaj
Përmet - Këlcyrë	Përmet dhe Këlcyrë
Sarandë - Delvinë- Konispol	Sarandë, Konispol dhe Delvinë
Lushnje	Lushnje
Vlorë - Himarë	Vlorë dhe Himarë

Fier	Fier
Gjirokastrë - Libohovë	Gjirokastrë dhe Libohovë

SHTOJCË 1

KRITERET DHE SKEMA E VLERËSIMIT TË DOSJEVE TË KANDIDATËVE PËR USHTRIMIN E PROFESIONIT TË MËSUESIT

1	Nota mesatare e studimeve të larta, e shprehur në numër me një shifër pas presjes dhjetore (nota mesatare e ciklit I + nota mesatare e ciklit II)/2, ose nota mesatare e studimeve të barasvlershme me to. Nota mesatare 5.00 - 5.50 = 0.5 pikë. Nota mesatare 5.51 - 6.00 = 1 pikë. Nota mesatare 6.01 - 6.50 = 1.5 pikë. Nota mesatare 6.51 - 7.00 = 2 pikë. Nota mesatare 7.01 - 7.50 = 2.5 pikë. Nota mesatare 7.51 - 8.00 = 3 pikë. Nota mesatare 8.01 - 8.50 = 3.5 pikë. Nota mesatare 8.51 - 9.00 = 4 pikë. Nota mesatare 9.01 - = 6 pikë. Nota mesatare 9.51 - 10.00 = 10 pikë.	0.5-10 pikë
2	Kategoria e kualifikimit: a) Mësues i Kualifikuar (kategoria III) 1-2 pikë (1 pikë për vlerësimin “Mjaftueshëm”, 1.5 pikë për vlerësimin “Mirë”, 2 pikë për vlerësimin “Shumë mirë” dhe “Shkëlqyeshëm”) b) Mësues Specialist (kategoria II) 3-4 pikë (3 pikë për vlerësimin “Mjaftueshëm”, 3.5 pikë për vlerësimin “Mirë”, 4 pikë për vlerësimin “Shumë mirë” dhe “Shkëlqyeshëm”) c) Mësues Mjeshtër (kategoria I) 5 pikë Për kandidatët që nuk e kanë në dëshmi nivelin e vlerësimit, do të llogaritet niveli “Shumë mirë”. Kandidati vlerësohet vetëm për kategorinë më të lartë të kualifikimit që zotëron.	0-5 pikë
3	Dëshmi të njohjes së gjuhës/ve të huaja: a) Gjuhë e huaj e mbrojtur në IAL-të publike = 1 pikë. b) Gjuhë e huaj e mbrojtur me testim ndërkombëtar niveli B1 = 1 pikë. c) Gjuhë e huaj e mbrojtur me testim ndërkombëtar niveli B2 = 2 pikë. Si gjuhë e huaj e mbrojtur llogaritet edhe rasti kur gjuha e huaj është e mbrojtur në kuadër të përfundimit të studimeve të ciklit të dytë, sipas legjislacionit përkatës. Dokumenti i gjuhës së huaj duhet të jetë lëshuar nga	0-2 pikë

	subjekte të njohura nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, për ofrimin e testeve ndërkombëtare dhe të jetë brenda afatit të vlefshmërisë. Lista e subjekteve është sipas Udhëzimit nr. 52, datë 3.12.2015, i ndryshuar. Pavarësisht se kandidati mund të ketë disa gjuhë të huaja të mbrojtura, në këtë rubrikë nuk mund t'i llogariten më shumë se 2 pikë në vlerësimin e dosjes. Në rast se kandidati ka mbrojtur të njëjtën gjuhë të huaj në dy institucione të ndryshme, do t'i llogariten pikë vetëm për dëshminë me vlerësimin më të lartë. Kandidatit të profilit gjuhë e huaj, i njihen pikët e kësaj rubrike, përveç gjuhës së huaj për të cilën është diplomuar.	
4	Trajnime: Vlerësimi bëhet sipas kësaj skeme: a) Certifikata trajnimesh me kredite të lëshuara nga institucione në varësi të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit ose nga agjenci trajnuese që janë akredituar nga ministria përgjegjëse për arsimin. a. 1 kredit =1 pikë. b. 2 kredite =2 pikë. c. mbi 3 kredite = 3 pikë.	0-3 pikë
5	Përvoja në punë si mësimdhënës dhe/ose drejtues institucioni arsimor.	0-10 pikë (0.5 pikë për çdo vit pune deri në 20 vite punë)